



UNIVERSITETI I PRISHTINËS

“HASAN PRISHTINA”

UNIVERSITY OF PRISTINA

FAKULTETI I NDËRTIMTARISË – CIVIL ENGINEERING FACULTY

Rr. Agim Ramadani, ndertesa e “Fakultetit Teknik”, 10000 Prishtinë, Kosovë

Tel: +383-38-548 644

URL: <http://www.fna.uni-pr.edu>

Mail: [fn@uni-pr.edu](mailto:fn@uni-pr.edu)

Ref. nr. 2223/1 Prishtinë 28.08 2022

## PUBLIKIMI I ABSTRAKTIT TË PUNIMIT TË DIPLOMËS MASTER

### DEPARTAMENTI HIDROTEKNIK

Studenti **Drilon Begaj** ka dorëzuar dorëshkrimin e punimit të diplomës Master me titull: “**Analiza hidraulike dhe dimensionimi i kapërdredhësit të pendat nga materiali rrethanor**” në programin e studimeve Master Hidroteknik dhe dorëshkrimi është në procedurë të vlerësimit përfundimtar deri në vendimin e këshillit të Fakultetit të Ndërtimtarisë. Sipas rregullores për studimet Master Shkencor të Universitetit të Prishtinës, abstrakti i shkurtër i punimit të diplomës bëhet publik për periudhën kohore prej pesë ditësh nga dita e shpalljes.

Punimi hulumtues me titullin “Analiza hidraulike dhe dimensionimi i kapërdredhësit të pendat nga materiali rrethanor”, fokusohet në përgjithësi në përzgjedhjen e një kapërdredhësi për pendën nga materiali rrethanor – rasti studimor, penda Kremenata. Qëllimi konkret i punimit është përzgjedhja e llojit dhe vendosjes së kapërdredhësit të duhur, duke zhvilluar analiza të mirëfillta për: kushtet hidrologjike, madhësinë dhe formën e pellgut ujëmbledhës, destinimin dhe mënyrën e shfrytëzimit të akumulacionit, pastaj analiza për bazamentin e kapërdredhësit, siç janë kushtet: gjeologjike, hidrogeologjike, topografike, si dhe kushtet hidraulike të kapërdredhësit. Kapërdredhësi i përzgjedhur ka për detyrë shkarkimin e ujërave vërshues nga akumulacioni për nivelin e caktuar maksimal të ujërave të sipërm dhe t’i bartë ato në pjesën e poshtme të rrjedhës në mënyrë të sigurt, pa shkaktuar dëmtim në konstruksionin e kapërdredhësit si dhe duke ruajtur integritetin e trupit të pendës.

Kapërdredhësi nga aspekti i sigurisë është objekt vital dhe shumë i ndjeshëm, njëashtu është komponenti më kompleks në ndërtimin e një pende. Kapërdredhësat zakonisht janë objekte të pa shfrytëzuara, por çdo pendë është e dimensionuar me të paktën një kapërdredhës. Këto fakte tregojnë nevojën e një grupi të madh inxhinierësh për komponimin, formimin dhe deri në konstruktimin e këtij objekti hidroteknik, që të mund të arrihet një zgjidhje sa më ekonomike, gjithnjë duke respektuar kërkesat e sigurisë.

Loji i kapërdredhësit i përzgjedhur për rastin tonë studimor është kapërdredhësi anësor me profil praktik, që nga aspekti konstruktiv është një strukturë betoni e cila vendoset në njërin krah të pendës pothuajse normal me aksin e pendës, respektivisht paralel me lumin ekzistues, për të kontrolluar nivelin e ujit maksimal në rezervuar.

Ngritja e nivelit të ujit në rezervuar mbi kuotën e pragut kapërdredhës kontrollues rezulton në kapërdredhjen e ujit në një kanal anësor, që karakterizohet nga hyrja anësore dhe me ndryshimin e drejtimit të rrjedhës hyrëse afërsisht 90°, më pas rrjedha vazhdon në kanalën bartës (pranues), duke vazhduar në një kanal të hapur (rrymëshpejtuesin) me pjerrtësi të madhe, dhe pastaj rrjedha e ujit qetësohet në pusin për shuarjen e energjisë para se të shkarkohet në rrjedhën e poshtme ekzistuese.

Me rezultatet e arritura nga ky hulumtim ipet një pasqyrë për vlerësimin e elementeve të nevojshme për dimensionimin dhe ndërtimin e një kapërdredhësi anësor në pendat nga materiali rrethanor, më saktësisht në pendën Kremenata si rast studimor, kapërdredhës i cili do të ketë funksion jetësor për bartjen e ujërave vërshues në mënyrë të sigurt.

Dorëshkrimi i punimit është i atashuar në sekretarinë e Fakultetit të Ndërtimtarisë dhe është i qasshëm për publikun. Çdo vërejtje, plotësim, ndryshim mund të deponohet me shkrim i protokolluar dhe do të merret për trajtim nga këshilli i Fakultetit të Ndërtimtarisë.